


# RIMËKËMBJE, GJITHPËRFSHIRJE, QËNDRUESHMËRI

Buletini nr. 03 —————>

TETOR 2021



**RINGJALLJE**  
**INVESTIM**  
**MBËSHTETJE**  
**QËNDRUESHMËRI**  
**KOORDINIM**  
**PUNËSIM**  
**MIRËQENIE**  
**BARAZI**  
**JETËSIM**  
**EKONOMI**

# Edicioni i Shpejtë



## Për buletin

Buletini "Rimëkëmbje, Gjithpërfshirje, Qëndrueshmëri" është pjesë e projektit "Rimëkëmbje për Qëndrueshmëri". Përmes monitorimit dhe hulumtimit synojmë ngritjen e nivelit të transparencës dhe informimin e saktë të qytetarëve sa i përket Pakos së Ringjalljes Ekonomike. Përveç se të informojë qytetarët rreth masave të ringjalljes ekonomike, ky buletin synon që të paraqet nivelin e zbatimit të masave krahas inkurajimit të hisedarëve drejt monitorimit të zbatimit të tyre. Buletini "Rimëkëmbje, Gjithpërfshirje, Qëndrueshmëri" është i realizuar në kuadër të projektit "Rimëkëmbje për Qëndrueshmëri" mbështetur nga Balkan Trust for Democracy (BTD) dhe USAID.

Edicioni i tretë i buletinit përmban informata dhe të dhëna rreth tre nënmasave të para të masës së parë. Këto nënmasa janë nën mbikqyrje dhe përgjegjësi të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), për arsye se lidhen direkt me shërbimet që ofron ky institucion. Duke zhvilluar intervista me akterë kompetentë të

temës që shtjellon buletini, synojmë të sjellim pikëpamjet dhe opinionet e tyre rreth masave që janë integruar në Pakon e Ringjalljes Ekonomike, e cila paraqet pakon e katërt të ndihmave për tejkalimin e pasojave të pandemisë COVID-19. INDEP ka zhvilluar intervistë me përfaqësuesin e Administratës Tatimore të Kosovës, përkatësisht me Drejtorin e Departamentit për Regjistrim dhe Shërbim të Tatimpaguesve, z. Sami Salihu, përmes të cilit kemi marrë të dhëna dhe detaje tjera rreth nënmasës 1.1., 1.2. dhe 1.3..

# → CILAT JANË TRE NËNMASAT E PARA TË MASËS SË PARË?

Dëmet e shkaktuara nga pandemia COVID-19, kanë prekur shumicën e sektorëve të zhvillimit ekonomik. Pasojat në të holla dhe në shëndetësi, janë vetëm disa nga pasojat, pasi që si rezultat i pandemisë, shumë qytetarë kanë humbur edhe vendet e tyre të punës. Andaj, masa e parë e Pakos së Ringjalljes Ekonomike, e quajtur Mbështetja e Punësimit, është paraqitur si prioritet për ndihmat të cilat do të ndahen tek qytetarët e prekur. Gjithsej kjo masë përfshin shtatë nënmasa, prej të cilave Administrata Tatimore e Kosovës ka mbikqyrjen për tre të parët. Këto nënmasa janë:

- 1.1.Rikthimi në punë i atyre që kanë humbur vendin e punës gjatë pandemisë – 10 mil EUR
- 1.2.Mbështetja për të punësuarit e formalizuar – 10 mil EUR
- 1.3.Mbështetja e punësimit të grave – 5 mil EUR

Si në përpilimin e pakove paraprake, të cilat kanë synuar lehtësimin e dëmeve të pandemisë, edhe në këtë pako, Administrata Tatimore e Kosovës ka qenë e përfshirë. Si mbikqyrëse, ATK-ja ka zhvilluar sisteme elektronike përmes të cilave lehtësohet aplikimi i qytetarëve për mbështetje nga masat e Pakos së Ringjalljes Ekonomike. Këto nënmasa prekin kategori mjaft të dëmtuara, prandaj edhe operacionalizimi i tyre ka qenë ndër të parët.

## ÇKA ËSHTË NËNMASA 1.1. → DHE KUSH PËRFITON NGA KJO NËNMASË?

Nënmasa 1.1., e quajtur Rikthimi në punë i atyre që kanë humbur vendin e punës gjatë pandemisë, ofron ndihmë për personat të cilat kanë humbur vendin e punës si pasojë e pandemisë dhe në periudhën tatimore dhjetor 2019 – shkurt 2020, rezultojnë të punësuar. Gjithsej kjo nënmasë ka të alokuara **10 milionë Euro**. Kjo nënmasë tashmë është operacionalizuar dhe qytetarët të cilët plotësojnë kriteret e nevojshme mund të aplikojnë përmes sistemit EDI apo ueb-faqes së Administratës Tatimore të Kosovës.

**Punëdhënësi mund të aplikojë përmes sistemit elektronik EDI të Administratës Tatimore të Kosovës, përmes formularit të veçantë që është i qasshëm në EDI. Vegëza për aplikim nga kjo nënmasë është: <https://apps.atk-ks.org/Subvencionim>.**

I punësuari mund të aplikojë përmes ueb-faqes së Administratës Tatimore të Kosovës. Vegëza për aplikim nga kjo nënmasë është: <https://www.atk-ks.org/services/>

Të drejtë aplikimi kanë shoqëritë tregtare të regjistruara, punëdhënësit dhe të punësuarit sipas legjislacionit të Kosovës. Punëdhënësi aplikon për subvencionim përmes sistemit EDI ndërsa i punësuari përmes ueb-faqes së Administratës Tatimore të Kosovës. Rrjedhimisht, përfitues nga kjo nënmasë janë edhe punëdhënësit edhe të punësuarit.

## Cilat janë kriteret dhe përfitimet nga nënmasa e parë e masës Mbështetja e Punësimit?

Kriteret që duhet plotësuar për të pasur përfitime nga nënmasa 1.1. Rikthimi në punë i atyre që kanë humbur vendin e punës gjatë pandemisë, janë:

**Duhet të jetë i deklaruar si i punësuar në periudhën tatimore dhjetor 2019 – shkurt 2020 dhe të jetë i deklaruar si i papunësuar në periudhën tatimore prill 2021 – qershor 2021.**

Punëdhënësi do të përfitojë për tre (3) muaj me rradhë, nga fillimi i subvencionimit, nga 50% të pagës bruto, e cila mund të jetë maksimalisht njëqind e shtatëdhjetë (170) Euro. Aplikimi për punëdhënësit ka filluar me datën 12 gusht 2021 dhe është i hapur deri me datën **15 tetor 2021, në ora 24:00**.

I punësuar do të përfitojë për tre (3) muaj me rradhë, nga fillimi i subvencionimit, shumë prej njëqind (100) Euro. Aplikimi për të punësuarit ka filluar me datën 23 shtator 2021 dhe është i hapur deri me datën **15 tetor 2021, në ora 24:00**.

## ÇKA ËSHTË NËNMASA 1.2. DHE ÇKA OFRON KJO NËNMASË?

Mbështetja për të punësuarit e formalizuar apo nënmasa e dytë e masës, Mbështetja e Punësimit, ofron mbështetje për personat të cilët janë të deklaruar dhe kryejnë obligimet tatimore me rregull. Duke parë rëndësinë e deklarimit si i punësuar dhe kontributit që i bëhet shtetit, përmes deklarimit të tillë, synohet inkurajimi i formalizimit të mëtutjeshëm. Kjo pasi që vetëm të punësuarit e formalizuar mund të jenë përfitues të mbështetjeve që ofron Qeveria e Republikës së Kosovës përmes Pakos së Ringjalljes Ekonomike.

### Por, çka është puna e formalizuar?

Puna e formalizuar i referohet punës në të cilën një kompani punëson një punonjës sipas një marrëveshje pune të përcaktuar që përfshin, pagën ose pagat, përfitimet shëndetësore dhe orët e punës dhe ditët e punës të përcaktuara.

Ashtu si nënmasa paraprake, edhe kjo nënmasë është operacionalizuar tashmë dhe përfituesit mund të aplikojnë përmes sistemit elektronik EDI dhe ueb-faqes së Administratës Tatimore të Kosovës. Përfitues të kësaj nënmasë mund të jenë punëdhënësit, të cilët formalizojnë punëtorët e tyre, e poashtu edhe të punësuarit që janë pjesë e kësaj kategorie. Shuma totale e alokuar për këtë nënmasë është **10 milionë Euro**.

**Punëdhënësi mund të aplikojë përmes sistemit elektronik EDI të Administratës Tatimore të Kosovës përmes formularit të veçantë që është i qasshëm në EDI. Vegëza për aplikim nga kjo nënmasë është: <https://apps.atk-ks.org/Subvencionim>.**

**I punësuari mund të aplikojë përmes ueb-faqes së Administratës Tatimore të Kosovës. Vegëza për aplikim nga kjo nënmasë është: <https://www.atk-ks.org/services/>**

## Cilat janë kriteret dhe përfitimet nga nënmasa e dytë e masës Mbështetja e Punësimit?

**Kriteri i cili duhet të përmbushet që aplikimi për subvencionim të jetë i suksesshëm është:  
I punësuar duhet të mos figurojë si i punësuar para periudhës tatimore qershor 2021 apo më herët, e që pastaj deklarohet në Administratën Tatimore të Kosovës.**

Punëdhënësi, përmes kësaj nënmase, nëse aplikimi është i suksesshëm, do të përfitojë për dymbëdhjetë (12) muaj me rradhë, 10% të kontributit pensional, e cila shumë nuk mund të jetë më e madhe se njëqind (100) Euro. Aplikimi për punëdhënësit ka filluar me datën 12 gusht 2021 dhe është i hapur deri me datën **15 tetor 2021, në ora 24:00**.

I punësuar do të përfitoj për tre muaj me rradhë, nga fillimi i subvencionimit, shumë prej pesëdhjetë (50) Euro. Aplikimi për të punësuarit ka filluar me datën 23 shtator 2021 dhe është i hapur deri me datën **15 tetor 2021, në ora 24:00**.



## NËNMASA 1.3. MBËSHTETJA E PUNËSIMIT TË GRAVE

Gratë përbëjnë thuajse gjysmën e popullësisë së Republikës së Kosovës. Sa i përket punësimit, gratë janë më pak të përfaqësuara, në raport me meshkujt. Duke u munduar që të krijohen të drejta të barabarta dhe përfaqësim i barabartë në secilën sferë të jetës, është parë e arsyeshme që në Pakon e Ringjalljes Ekonomike të integrohet edhe nënmasa, e cila direkt mbështet punësimin e grave. Shuma totale e alokuar për këtë nënmasë është **5 milionë Euro**. Edhe kjo nënmasë ka filluar zbatimin apo operacionalizimin dhe aplikimet janë të hapura për personat të cilët plotësojnë kriteret e vendosura nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Liria për të punuar sipas zgjedhjes në kushtet e dinjitetit, sigurisë dhe drejtësisë, është pjesë përbërëse e mirëqenies njerëzore. Garancia që gratë të kenë akses në këtë të drejtë është një qëllim i rëndësishëm në vetvete. Nga një perspektivë ekonomike, zvogëlimi i boshëllëqeve gjinore në pjesëmarrjen e fuqisë punëtore mund të rrisë ndjeshëm PBB-në. Rajonet me hendek më të madh gjinor, siç është edhe vendi ynë, do të kenë përfitime të mëdha të rritjes, nëse aplikojnë kushte për barazi të punësimit.

**Punëdhënësi mund të aplikojë përmes sistemit elektronik EDI të Administratës Tatimore të Kosovës përmes formularit të veçantë që është i qasshëm në EDI. Vegëza për aplikim nga kjo nënmasë është: <https://apps.atk-ks.org/Subvencionim>.**

**E punësuara mund të aplikojë përmes ueb-faqes së Administratës Tatimore të Kosovës. Vegëza për aplikim nga kjo nënmasë është: <https://www.atk-ks.org/services/>**



## Cilat janë kriteret dhe përfitimet nga nënmasa e tretë e masës Mbështetja e Punësimit?

**Kriteri i cili duhet të përmbushet që aplikimi për subvencionim për këtë nënmasë të jetë i suksesshëm është:**

**E punësuar duhet të mos figurojë si e punësuar para periudhës tatimore qershor 2021 apo më herët, e pastaj të deklarohet në Administratën Tatimore të Kosovës.**

Kjo nënmasë parasheh që punëdhënësi të përfitojë për tre (3) muaj nga 50% të pagës bruto, e cila shumë nuk mund të jetë më e madhe se njëqind e pesëdhjetë (150) Euro dhe për nëntë (9) muajt e tjerë të marrë 10% të kontributit pensional, shumë e cila nuk mund të jetë më e madhe se njëqind (100) Euro. Aplikimi për punëdhënësit ka filluar me datën 12 gusht 2021 dhe është i hapur deri me datën **15 tetor 2021, në ora 24:00.**

E punësuar do të përfitojë për tre (3) muaj, shumën prej pesëdhjetë (50) Euro. Aplikimi për të punësuarit ka filluar me datën 23 shtator 2021 dhe është i hapur deri me datën **15 tetor 2021, në ora 24:00.**



## TË DHËNA RRETH APLIKIMEVE PËR TRE NËNMASAT E PARA →

Në tabelën e mëposhtme janë të paraqitura aplikimet e bëra nga punëdhënësi për tre nënmasat e para të masës së parë. Nga të dhënat vërehet që interesi apo aplikimet më të mëdha janë bërë për nënmasën e tretë të masës së parë apo nënmasa e quajtur Mbështetja e punësimit të grave, ku gjithsej kanë arritur 845 aplikime apo kërkesa, për 1590 punëtor.

Punëdhënësi					
Masa 1.1.		Masa 1.2.		Masa 1.3.	
Kërkesa	Punëtor	Kërkesa	Punëtor	Kërkesa	Punëtor
232	539	320	929	845	1590

Në tabelën e mëposhtme janë të paraqitura aplikimet e bëra nga të punësuarit për tre nënmasat e para të masës së parë. Nga të dhënat vërehet që interesi apo aplikimet më të mëdha janë bërë për nënmasën e dytë të masës së parë apo nënmasa e quajtur Mbështetja për të punësuarit e formalizuar, ku gjithsej kanë arritur 565 aplikime apo kërkesa.<sup>1</sup>

Të punësuarit					
Masa 1.1.		Masa 1.2.		Masa 1.3.	
Kërkesa	Punëtor	Kërkesa	Punëtor	Kërkesa	Punëtor
169	169	565	565	217	217

<sup>1</sup> Të dhënat për hartimin e këtij buletini janë marrë nga metoda e hulumtimit në tavolinë dhe intervista e realizuar nga INDEP me përfaqësuesin e Administratës Tatimore të Kosovës, Drejtorin e Departamentit për Regjistrim dhe Shërbim të Tatimpaguesve, z. Sami Salihu, me datë 28 shtator 2021.

## REKOMANDIME

1. Qeveria e Kosovës, në bashkëpunim me Administratën Tatimore dhe Agjencinë e Statistikave të Kosovës, të evidentoj numrin e punëtorëve që po kthehen në punë si rezultat i kësaj mase. Këtë numër, bashkë me statistikat e numrit të personave që kanë humbur vendin e punës, duhet ta paraqesin në pamje krahasuese dhe në baza të rregullta.
2. Institucionet të shoqërojnë masën e dytë të formalizimit të bizneseve me më shumë punë monitoruese. Në veçanti duhet parë nëse formalizimi po shkakton ulje të pagave të punëtorëve aktual të cilët do të lajmërohen apo ulje të pagës të barasvlefshme për shumën e cila do t'u jepet punëtorëve si incentivë.
3. Në të ardhmen të shtohen mjetet për masën 1.3 “Mbështetja e punësimit të grave”. Të dhënat e para flasin për numër më të madh të aplikimeve për këtë nënmasë në krahasim me nënmasat tjera ndonëse buxheti i ndarë është përgjysmë më i vogël. Duke marrë në konsideratë edhe pabarazitë historike në numrin e të punësuarve gra në krahasim me punëtorët burra, nevoja për rritjen e mbështetjes për këtë kategori është e konsiderueshme.
4. Të targetohen gratë me kampanja të vetëdijësimit. Të dhënat tregojnë që ndonëse aplikimet nga punëdhënësit janë më të mëdha për masën 1.3 – “Mbështetja e punësimit të grave”, aplikimet nga punëtorët gra janë thuajse dyfish më të vogla sesa për masën 1.2. Kjo do të thotë që ndonëse nevoja e grave për mbështetje është e madhe, hezitimi i tyre për aplikim është po ashtu i qartë.



**“Opinionet e shprehura në këtë botim nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Balkan Trust for Democracy, Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, USAID-it apo të Qeverisë Amerikane.”**